



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.195/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS), paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të Thyerjes së Kodit të Mirësjelljes, për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatet, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 16.10.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS), me të cilën ka kërkuar që ti shqiptohet dënimi me gjobë subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të Thyerjes së Kodit të Mirësjelljes, për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatet.

## A r s y e t i m

Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS), ka parashtruar ankesë në PZAP më datë 12.10.2017, me të cilën pretendon se kandidati për kryetar të Komunës së Prishtinës, nga radhët e subjektit politik LDK-së, Arban Abrashi, në faqen e tij të Facebook-ut, më datë 11.10.2017, ka publikuar tubimin zgjedhor, i mbajtur në një shkollë në Kodrën e Trimave në Prishtinë, ku shihet se disa fëmijë të veshur me bluza me shenja identifikuese të subjektit politik LDK. Me këtë rast është shkelur neni 5.2 i Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur një CD, nga vendi ku ka ndodhur shkelja.

Në përgjigjen në ankesë të datës 13.10.2017, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka theksuar se ankesa e BIRN-it dhe IKS është plotësisht e pa bazuar për arsye se nëse e analizojmë me vëmendje CD, vërehet se në sallën ku është mbajtur tubimi elektoral i LDK-së nuk ka asnjë fëmijë të pranishëm por vetëm në hyrje të shkollës, andaj LDK ka theksuar se nuk mban përgjegjësi, sepse nuk mund ti kontrollojmë ato që zhvillohen në rrugë apo në oborrin e shkollës, por vetëm ato çfarë ndodhin në lokacionin ku është thirrur zyrtarisht tubimi. Më tej LDK thekson se ka kërkuar që videoja në fjalë të largohet nga rrjetet sociale, të korrigjohet në kuptimin e postimit të vetëm sekuencave nga tubimi elektoral dhe jo ato që janë regjistruar gjatë hyrjes së kandidatit Arban Abrashi.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Pretendimet ankimore se kandidati për kryetar të Komunës së Prishtinës nga radhët e subjektit politik LDK, Arban Abrashi, se ka përfshirë fëmijë në një tubim zgjedhor duke shkelur kështu dispozitat e LPZ-së, të njëjtat pretendime ankimore nuk qëndrojnë sepse, nga video inqizimi i ofruar nga ana e parashtruesit të ankesës BIRN, si dhe nga pretendimet e ofruara në përgjigjen në ankesë nga subjekti politik LDK, Paneli vërteton se nga video incizimi shihet qartë se fëmijët gjinden në oborrin e shkolles dhe nuk kanë të bëjnë me tubimin zgjedhor prandaj, ky veprim nuk ka të bëjë me shkeljen e nenit 5.2 të Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Andaj paneli erdhi në përfundim se janë të paqëndrueshme parashkrimet në ankesë se është Thyer Kodi i Mirësjelljes nga subjekti politik LDK. Me këtë rast paneli konsideron, se parashtruesi i ankesës, me dëshmitë e ofruara nuk i ka vërtetuar pretendimet e tij në mënyrë që paneli, të merr vendim në favor të tij.

Duke u bazuar në arsyet e dhëna më lartë dhe në kuptim të nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
ZL.Anr.195/2017 më datën 16.10.2017.



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.